



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Përmbledhje e raportit të monitorimit të procesit të ngritjes së organeve të reja të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nëpërmjet votimit në Kuvend me datë 23.07.2020 të Ligjit Nr. 101/2020 ‘‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 019 datë 29.12.2008’’ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë pësoi ndryshime, duke riorganizuar dhe mënyrën e përbërjes dhe strukturimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim KQZ).

KQZ, sipas nenit 12 të Kodit Zgjedhor, është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor. Si pasojë e ndryshimeve ligjore, KQZ tanimë përbëhet nga tre organe drejtuese, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (në vijim KShH) në përmbushje të misionit të tij dhe në vijim të praktikës së monitorimit të proceseve zgjedhore, por dhe për shkak të rëndësisë dhe risive që sollën ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ndoqi me vëmendje dhe monitoroi procesin e ngritjes së organeve të reja të KQZ-së.

KShH vëren se Kuvendi zgjodhi anëtarët e organeve të reja të KQZ-së brenda afatit ligjor prej 60 ditësh që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, sipas përcaktimit në nenin 182 të Kodit Zgjedhor. Por përgjatë këtij procesi, KShH vëren me shqetësim praktikën e ndjekur nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të KQZ-së, kryesisht për sa i përket respektimit të parimit të transparencës nga ana e Kuvendit dhe depolitizimit të strukturave të KQZ-së.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar përjashtoi në fazën e parë, e cila i paraprin fazës së intervistimit, 17 aplikantë me anë të një seance të mbyllur. Gjithashtu, dhe votimi i aplikantëve të intervistuar është zhvilluar sërish në një seancë të mbyllur. Për rrjedhojë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, përkatësisht dispozitat nr. 34, 35, dhe 105, për sa i përket zhvillimit të seancave të hapura dhe garantimit të transparencës ndaj publikut.

Në fazën e dytë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi dy seanca publike për intervistimin e kandidatëve, me datë 29 dhe 30 shtator. Mbi 50 aplikantë janë intervistuar përgjatë dy seancave të zhvilluara, secila me kohëzgjatje përreth 4 orë. Gjykohet se koha e shfrytëzuar për intervistimin e aplikantëve është e pamjaftueshme për të vlerësuar efektivisht përputhshmërinë e kandidatëve me kriteret e caktuara ligjore dhe për të arritur në përzgjedhjen e kandidatëve të përshtatshëm për pozicionet vakante.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Kodi Zgjedhor, në nenin 183 ka parashikuar një procedurë të detajuar mbi mënyrën e përzgjedhjes dhe votimit të kandidatëve për pozicionet vakante në KQZ, por respektimi i kësaj procedure është i vështirë për t'u vlerësuar për shkak se Komisioni i Posaçëm Parlamentar e zhvilloi seancën e votimit të mbyllur dhe publikoi vetëm rezultatin përfundimtar. Gjithashtu, në funksion të respektimit të parimit të transparencës, në faqen e Kuvendit nuk janë publikuar jetëshkrimet e aplikantëve, me qëllim njohjen nga publiku, apo platformat e tyre për kandidim, në rast se ka patur të tilla.

Sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor “*personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nëse në momentin e kandidimit ka qenë në ushtrim të detyrës si funksionar, anëtar i kabinetit, nëpunës i nivelit të lartë drejtues, apo drejtues i organizatës jofitimprurëse, ose kur komisioni kompetent i Kuvendit krijon bindjen se marrëdhënien e tij të punës e ka ndërprerë për shkak të kandidimit ose propozimit për komisioner*”. Anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar i kushtuan një kohë të kufizuar intervistimit të kandidatëve, e pamjaftueshme për të kuptuar respektimin e dispozitave ligjore të sipërcituara.

Kodi Zgjedhor, gjithashtu, ka parashikuar se “*personi që kandidon ose që propozohet për komisioner nuk përfshihet në listën e kandidatëve që votohen nga Kuvendi nëse është anëtar aktiv i ndonjë partie politike, ose nëse ka interesa private, të dukshme ose të njohura, plotësimi i të cilave varet nga qeverisja në nivel qendror ose vendor*”. Ndërkohë, nëpërmjet vrojtimeve të kryera nga KShH, vërehet se disa nga kandidatët e zgjedhur në strukturat e reja të KQZ-së kanë shërbyer në pozicione politike në legjislaturat e mëparshme ose, pavarësisht se jo detyrimisht në funksionin e anëtarit aktiv, kanë asistuar partitë politike në dhënien e ekspertizës.

Për sa më sipër, qartësisht evidentohet se Komisioni i Posaçëm Parlamentar nuk hulumtoi mjaftueshëm nëse anëtarët e rinj të KQZ janë anëtar aktiv të ndonjë partie politike në përputhje me nenin 13, pika 5 dhe neni 16, pika 5 të Kodit Zgjedhor, si dhe nuk janë ndjekur plotësisht rekomandimet e OSBE/ODIHR për depolitizimin e KQZ-së.